

URDHËR
Nr. 1, datë 5.1.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe të udhëzimit nr. 22, datë 10.7.2013 “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit””,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Integrimit European, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Daniela Çekani, për autorizimin e dërgimit të punonjësve me shërbim jashtë vendit.
2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Integrimit European, do të ushtrohet për periudhën nga data 5.1.2017 deri më 31.12.2017.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit European, znj. Daniela Çekani.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN
Klajda Gjoshë